



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2023, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, Komuna e Prishtinës dhe P. Sh Ujërat, me pronat e paluajtshme në pronësi të bashkëpronarëve dhe pronarëve: Besim (Lika) Namani, Naim (Isa) Berisha, Idriz (Halit) Blakqori, Arsim (Esat) Blakqori, Hajdin (Izmi) Berisha, Zenel (Izmi) Berisha, Zymer (Izmi) Berisha, Ilmi (Izmi) Berisha, Shaqir (Salih) Emmini, Milot (Isuf) Berisha, Fitim (Izmi) Berisha, Hatixhe (Bajram) Orani, Neron (Isuf) Berisha, Alban (Feriz) Blakqori, Florim (Omer) Gashi, Ilir (Omer) Gashi, Nazife (Bajram) Namani, Shefkije (Bajram) Blakqori.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesa e parcelave kadastrale nr.1640, me sipërfaqe prej 657m², Certifikata e pronësisë P- 71914059-01640-0; parcela kadastrale nr. 1637-0 me sipërfaqe prej 2673 m², Certifikata e pronësisë P- 71914059-01637-0, si dhe parcela kadastrale nr.1958-0 me sipërfaqe 180 m², Certifikata P- 71914059-01958-0, Zona Kadastrale Prishtinë, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01 nr.035-186861, dt. 2.10.2013, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, janë parcelat kadastrale nr. 899-0 me sipërfaqe 312m², Certifikata e pronësisë nr. P- 71914050-00899-0, parcela kadastrale nr. 898-0 me sipërfaqe 911m², Certifikata e pronësisë nr. P- 71914050-00898-0, parcela kadastrale nr. 905-1 me sipërfaqe 570 m², Certifikata e pronësisë nr. P- 71914050-00905-1, parcela kadastrale nr. 905-2 me sipërfaqe 327 m², P- 71914050-00905-2, parcela kadastrale nr. 905-3, me sipërfaqe 346 m²; Certifikata e pronësisë, P- 71914050-00905-3, parcela kadastrale nr. 903-0 me sipërfaqe 624 m², Certifikata e pronësisë, P- 71914050-00903-0, parcela kadastrale nr. 1688-3 me sipërfaqe 324 m², Certifikata e pronësisë, P-71914050-01688-3 dhe parcela kadastrale nr. 1688-5 me sipërfaqe 96 m², Certifikata e pronësisë P-71914050-01688-5, Zonat Kadastrale Matičan Prishtinë, në pronësi dhe në bashkëpronësi të: Besim (Lika) Namanit, Naim (Isa) Berishës, Idriz (Halit) Blakqorit, Arsim (Esat) Blakqorit, Hajdin (Izmi) Berishës, Zenel (Izmi) Berishës, Zymer (Izmi) Berishës, Ilmi (Izmi) Berishës, Shaqir (Salih) Emmini, Milot (Isuf) Berishës, Fitim (Izmi) Berishës, Hatixhe (Bajram) Oranit, Neron (Isuf) Berishës, Alban (Feriz) Blakqorit, Florim (Omer) Gashit, Ilir (Omer) Gashit, Nazife (Bajram) Namanit, Shefkije (Bajram) Blakqorit, me destinim infrastrukturë rrugore, konkretisht në rrugën "A", të planifikuar sipas Planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01nr.035-186861, dt. 2.10.2013.

- III.** Këmbimi i parcelave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të projektit të rrugës "A" sipas Planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01 nr.035-186861, dt. 2.10.2013.
- IV.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të Pronës së paluajtshme të komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V.** Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelave kadastrale që do të këmbehen.
- VI.** Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII.** Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
 - kopjet e planit dhe
 - certifikatat e njësisë kadastrale.
- IX.** Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/03-204132/23, më 10.10.2023



Arsyetim

Në bazë të kërkesës së Kryetarit të Kryeqytetit dhe Drejtorisë së Investimeve Kapitale, që të fillojmë me procedurën e kompensimit për parcelat, të cilat përfshihen brenda Planit rregullues për zhvillimin e projektit të rrugës "A", si dhe bazuar në Planin rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01 nr.035-186861, dt. 2.10.2013, ka dhënë pëlqimin për këmbimin e pjesëve të parcelave kadastrale nr. 1640-0 me sipërfaqe prej 657 m², 1637-0 me sipërfaqe 2673 m² dhe 1958-0 me sipërfaqe 180 m², Zona Kadastrale Prishtinë në pronësi të Komunës së Prishtinës, me destinim ndërtim të planifikuar. Parcela kadastrale me nr. 899-0 me sipërfaqe 312 m², nr. 898-0 me sipërfaqe 911 m², nr. 905-1 me sipërfaqe 570 m², nr. 905-2 me sipërfaqe 327 m², nr. 905-3 me sipërfaqe 346 m², nr. 903-0 me sipërfaqe 624 m², nr. 1688-3 me sipërfaqe 324 m² dhe nr. 1688-5 me sipërfaqe 96 m², Zona Kadastrale Matiçan, me destinim infrastrukturë rrugore e cila përfshihet në kuadër të projektit të rrugës "A" Jim Xhema Prishtinë, sipas Planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01 nr.035-186861, dt. 2.10.2013.

Propozimi për iniciimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të projektit të rrugës "A" sipas Planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01 nr.035-186861, dt. 2.10.2013. Parcelat me nr. 1640-0 me sipërfaqe prej 657m², nr. 1637-0 me sipërfaqe 2673 m² dhe nr. 1958-0 me sipërfaqe 180 m², Zona Kadastrale Prishtinë, shtrihen në zonë të planifikuar për ndërtim, ndërsa parcelat me nr. 899-0 me sipërfaqe 312 m², nr. 898-0 me sipërfaqe 911 m², nr. 905-1 me sipërfaqe 570 m², nr. 905-2 me sipërfaqe 327 m², nr. 905-3 me sipërfaqe 346 m², nr. 903-0 me sipërfaqe 624 m², nr. 1688-3 me sipërfaqe 324 m² dhe nr. 1688-5 me sipërfaqe 96 m², Zona Kadastrale Matiçan, shtrihen në zonë të planifikuar për infrastrukturë rrugore, sipas Planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" Prishtinë.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore, të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.